



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:070708

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05616950

2024:070709

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.R nga Kaçaniku, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit, nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr.494/23 të dt.28.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 05.04.2024 mori dhe shpalli, ndërsa më datë 24.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri G.R nga Kaçaniku, Rruga "... "pn. , i lindur më dt.... nga i ati R... dhe e ëma B... , e gjinisë B..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. Personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 29 Mars te vitit 2023 ne Kacanik, saktesisht në vendin e quajtur “Tuma Llakës” në Rajonin Pyjor të Kacanikut, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetit t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.08/L-137, në atë mënyrë që shkon tek vendi i lartpërmendur dhe me sharrë motorrike i pren 59 copë drunj me diameter 8-22 cm, me lartësi 10-12 metra dhe me vëllim të përgjithshëm prej 4.38 m³, të njejtat i shkurton dhe i bënë të gatshme për t’i bartur me një mushkë me samar, me ç’rast të dëmtuarës DBZHRP-Komuna Kacanik, i ka shkaktuar dëm material në vlerë të përgjithshme prej 596.60 € .

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 300.00 € (treqind euro) , të cilën I pandehuri është i obliguar që t’a paguajë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, në tri këste mujore, në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t’a zëvendesoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njejtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t’i paguajë dëmin në vlerë prej 596.60 € në afat të njejtë me gjobën.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën: PP/II.nr.494/23 të datës 28.02.2024, e akuzoi te pandehurin G.R nga Kaçaniku, për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.04.04.2024 me të cilin rast, prokurori I shtetit Sadat Topalli, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës nuk ka qenë prezent në seancën e shqyrtimit fillestar.

I pandehuri në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar, e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke shtuar se drutë kishte për qëllim që t'i shfrytëzojë për nevojat e ekonomisë familjare, por që i premtonte gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, njeherit I kërkon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPK-së, pasi që i njëjti është deklaruar vullnetarisht dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë dhe ky pranim i fajësisë mbështet edhe në faktet dhe provat mbi bazën të cilave është ngritur aktakuza, dhe nuk ka asnjë rrethanë e cila të pandehurin mund ta përjashtojë nga përgjegjësia penale. Andaj, edhe kërkon nga gjykata që të aprovojë pranimin e fajësisë, të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, duke patur parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri si rrethanë lehtësuese, premtimin e tij se nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme në të ardhmen, kurse si rrethanë rënduese të merret parasysh, shkalla e lartë e dashjes nga i pandehuri për të kryer veprën penale, dëmi i shkaktuar të dëmtuarës, prandaj edhe i kërkon gjykatës që t'i shqiptojë sanksion penale sipas ligjit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban

akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike, prandaj edhe pranoi pranimin e fajësië për të pandehurin.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit te dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, jeton në kushte të dobëta ekonomike, gjegjësisht me asistencë sociale, ndërsa si rrethanë te posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës, i pandehuri përveq që ka qenë i dënuar edhe më parë për dy vepra penale, ka patur edhe raste tjera kundërvajtëse, të po kësaj natyre, për të cilat poashtu është shpallur përgjegjës me aktgjykime të plotëfuqishme, pra mund të konsiderohet përsëritës i këtyre veprimeve.

Andaj gjykata, për këto arsye të pandehurin G.R, I akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe të mos kryejnë vepra te tilla penale duke ngritur vetëdijësimin per respektimin e ligjit dhe se me ketë do të arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2024:070709 datë 24.04.2024

Sekretarja Juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.